

Prishtinë, 09/11/2006
Kodi i ZRrE-së: D_22_2006

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_03_2006 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”;
4. Aplikacionin për tarifatat e ngrohjes në sezonin 2006/2007 dorëzuar nga ana e Ndrohtores së Qytetit (NQ) Gjakovë SH.A. Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) më datë 14 shtator 2006;
5. Komentet për aplikacionin për tarifa të dhëna nga ana e ZRrE-së me datë 26 shtator 2006;
6. Aplikacionin për tarifatat, të rishikuar, të NQ Gjakovë SH.A. dorëzuar me datë 29 shtator 2006;
7. Vendimin D_18_2006 mbi Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakovë SH.A. për sezonin e ngrohjes 2006/2007, nxjerrë nga ana e ZRrE-së me datë 30 tetor 2006, shoqëruar nga ANEKSI “RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakovë SH.A., për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”.
8. Propozimin e tarifave dorëzuar nga ana e NQ Gjakovë SH.A. Zyrës së Rregullatorit për Energji më 6 nëntor 2006; letra nr. 729, e datës 6 nëntor 2006.

Ka vendosur që:

1. Të aprovojë tarifatat për NQ Gjakovë SH.A. për tërë gjashtëmujorin e sezonit të ngrohjes 2006/2007 siç është paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe llogaritja detale e paraqitur në ANEKSin e këtij vendimi “ RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i Tarifave për NQ Gjakovë SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”.
2. Tarifatat e aprovuara do të publikohen nga ana e NQ Gjakovë SH.A. në njërin nga gazetatat kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat e paraqitura dhe faturat në të cilat është bazuar llogaritja e tarifave gjatë periudhës së ardhshme të ngrohjes.
4. Gjatë sezonit të ngrohjes 2006/2007 NQ Gjakovë SH.A. mund të paraqesë para Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimin për ndryshime të arsyeshme të tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja në pajtim me Udhëzimin e Përkohshëm I_03_2006 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”.

5. NQ Gjakovë SH.A. ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.

**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A.
PËR SEZONIN E NGROHJES 2006/2007**

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PA-NJEHSUAR

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Amvisri	Komerical dhe Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 0.18 / m2 për muaj	€ 0.23 / m2 për muaj
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 0.69 / m2 për muaj	€ 1.03 / m2 për muaj

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 1.86 / kW
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 50.10 / MWh

Inkurajojmë Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore që të matin konsumin e ngrohjes nëpër nënstacione sa më shumë që të jetë e mundur përmes njehsorëve të kalibruar të ngrohjes, posaçërisht për konsumatorët komercialë dhe institucionet.

Bordi i ZRrE-së:

Nick Frydas, Kryesues,

Nysret Avdiu, anëtar

Merita Kostari, anëtare,

Naim Bejtullahu, anëtar

Theranda Beçiri, anëtare